



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0000932-2/26 dt. 08.01.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 54, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, dhe paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0000932/26, dt. 08.01.2026, të Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë për formimin dhe aktivizimin e Qendrës Operative Emergjente Lokale për Menaxhimin e Vërshimeve, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin dhe Aktivizimin e Qendrës Operative Emergjente Lokale për Menaxhimin e Vërshimeve)

1. Formohet dhe aktivizohet Qendra Operative Emergjente Lokale për Menaxhimin dhe zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit, ndihmës dhe detyrave tjera operative brenda fushëveprimit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, gjegjësisht për menaxhimin e vërshimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
 - 1.1. Faton Peci – Kordinator, Kryetar i Komunës;
 - 1.2. Shkëlzen Haliti – Shef i Qendrës Operative Emergjente Lokale;
 - 1.3. Besim Beka – anëtar, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë;
 - 1.4. Idriz Beqiri – anëtar, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë;
 - 1.5. Remzi Muja – anëtar, Drejtori për Administratë të Përgjithshme;
 - 1.6. Bahtir Maxhuni – anëtar, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë;
 - 1.7. Berat Jashari – anëtar, Drejtoria e Shëndetësisë;
 - 1.8. Fisnik Ibrahim – anëtar, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë;
 - 1.9. Nexhat Rushiti – anëtar, Drejtoria për Mirëqenie Sociale;
 - 1.10. Kreshnik Zejnullahu – anëtar, Drejtoria e Arsimit;
 - 1.11. Bedri Bajrami – anëtar, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
 - 1.12. Zenel Çitaku – anëtar, Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
 - 1.13. Ahmet Xhoshë – anëtar, Komandat i Stacionit të Policisë në Jug;
 - 1.14. Burim Ibishi – anëtar, Shef i Njësisë Zjarrfikëse, Shërbimi për Zjarrfikës dhe Shpëtim;
 - 1.15. Irfan Peci – anëtar, Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit;
 - 1.16. Qendresa Rexhepi – anëtar, përfaqësues i Kryqit të Kuq;
 - 1.17. Fadil Begu – anëtar, Drejtor i KEDS në Mitrovicë;

- 1.18. Bashkim Kurti – anëtar, Drejtor i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica”;
- 1.19. Sofije Idrizi Peci – anëtare, Zyra për Informim;
- 1.20. Një anëtar, Përfaqësues nga FSK-ja;
- 1.21. Samedin Peci – anëtar, QOER - 112.
2. Detyrë e kësaj Qendre Operative Emergjente Lokale është menaxhimi dhe zbatimi i mbrojtjes, shpëtimit, ndihmës dhe detyrave tjera operative brenda fushëveprimit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, gjegjësisht për menaxhimin e vërshimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
3. Bazë për punën e tyre, anëtarët e kësaj Qendre Operative Emergjente Lokale do të kenë Planin Operativ Emergjent, ku janë të specifikuara të gjitha aktivitetet e linjës për secilin anëtar të cekur në pikën I (një) të këtij Vendimi, duke u mbështetur secili në aktivitet e tyre ditore që ndërlidhen me emergjencë, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Shtojcë:

1x1 Propozim-Vendimi Nr. Nr. 01-020/04-0000932/26, dt. 08.01.2026 i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë.

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë
- 1x1 Anëtarëve të Qendrës Operative Emergjente Lokale
- 1x1 Arkivit.

